



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11, 12.2 shkronja d) nenin 17 dhe nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11 paragrafi 1.15; 17 paragrafi 5; neneve 20 dhe 26 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin hapësinor, nenit 4 paragrafi 3.3; 7 paragrafi 2; neneve 8; 10 dhe 12 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, Udhëzimin Administrativ MMPH nr.01/18 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, Udhëzimin Administrativ MMPH nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, dhe Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 për administratë të hapur në komunë, si dhe neneve 14, 15, 34.2 dhe nenin 64 paragrafi 2.5 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 04 mars 2024, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR VËNIE NË SHQYRTIM PUBLIK TË PROJEKT DOKUMENTIT TË PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR ZONËN INDUSTRIALE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

1. Me këtë vendimit vëhet në shqyrtim publik Projekt Dokumenti i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale në Zonat Kadastrale Podujevë dhe Livadicë - Komuna e Podujevës
2. Projekt dokumenti nga 1 i këtij vendimi, përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Pjesëmarrja dhe shqyrtimi publik

1. Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale sipas këtij vendimi, bëhet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit më **22.03.2024, në ora 14:00**. Konsultimi fillestar publik caktohet të mbahet më **26.03.2024** nga ora **10:00** në sallën e mbledhjeve të Kuvendit.

2. Shqyrtimi publik i Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale, zgjat 30 ditë përkatësisht nga data **22.03.2024 deri më 22.04.2024** sipas procedurave të përcaktuara me ligj.

3. Shpallja e shqyrtimit publik të Projekt Dokumentit të Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale sipas këtij vendimi, bëhet tetë (8) ditë para hapjes së tij përmes mjeteve të informimit publik, përkatësisht në ueb faqe të Komunës.

4. Projekt Dokumenti i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/> (Rubrika; Aktet për diskutim publik) si dhe në Platformën Qendrore të Konsultimeve Publike <https://konsultimet.rks-gov.net>

5. Projekt Dokumenti i Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën Industriale i nënshtrohet vërejtjeve, komenteve dhe sugjerimeve të publikut para se të finalizohet.

6. Të gjitha vërejtjet, komentet dhe sugjerimet që paraqiten nga publiku gjatë diskutimeve me shkrim në librin e vërejtjeve apo përmes adresave elektronike; blerina.zeka@rks-gov.net dhe info.podujeva@rks-gov.net brenda afatit kohor, përfshihen në Raportin mbi shqyrtimin publik.

7. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, Projekt Dokumenti i cekur së bashku me një përmbledhje të shkurtë të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik dhe raportin përkatës do ti dorëzohen Kuvendit të Komunës së Podujevës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 3

Subjekti përgjegjës

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si Autoritet për planifikim hapësinor, është përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi në bashkërendim dhe bashkëpunim me autoritetet tjera përkatëse sektoriale përgjegjëse.

Neni 4

Kufiri i territorit

Zona Industriale për të cilën është hartuar Projekt Dokumenti i Planit Rregullues i Hollësishëm përfshinë një sipërfaqe prej 613911 m². Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të Zonave Kadastrale Podujevë dhe Livadicë.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-944/01-0015793/24
Podujevë, datë; 04 mars 2024

